



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.39

Prishtinë, më 26.1.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Sergjan Popoviq, Shpejtim Bulliqi, Bekim Haxhiu dhe Mufera Shinik.

Munguan: Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësues të Ministrisë së arsimit, OSBE-së, KDI-së.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.1.2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.1.2016;

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 20.1.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës;

Kryetari i Komisionit, Nait Hasani, tha se Projektligji për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës, është shqyrtuar në Komision më 27.10.2015, para miratimit në parim, ndërsa leximi i parë është bërë më 30.10.2015. Me këtë projektligj për herë të parë rregullohet fusha e profesioneve të rregulluara në Republikën e Kosovës, lidhur me këtë kemi një hulumtim të bërë nga KDI-ja, që pasqyron praktikat e vendeve të rajonit që e kanë një ligj të tillë.

Anëtarët e Komisionit filluan me shqyrtimin nen për nen dhe propozuan amendamentet si vijon:

Amendamenti 1

Neni 1, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, riformulohet si vijon:

1.3. Lehtësimin e mobilitetit profesional ndërmjet Kosovës dhe vendeve të tjera, në bazë të direktivave të BE-së:

Neni 1, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3.2, fjalët ”direktiva amendues” zëvendësohen me fjalët ”direktivën e amendamentuar”.

Amendamenti 2

Neni 2, paragrafi 2, riformulohet si vijon:

2. Ky Ligj zbatohet për personin i cili kërkon të punojë në një profesion të rregulluar në Republikën e Kosovës.

Amendamenti 3

Neni 3, nënparagrafi 1.5, riformulohet si vijon:

1.5. Diploma ose certifikata - Dokument i kualifikimit profesional, e cila lëshohen nga autoriteti kompetent brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Neni 3, nënparagrafi 1.6, riformulohet si vijon:

1.6 Agjencia e Kosovës për Standarde dhe Vlerësim - AKSV - organi kompetent i themeluar nga Qeveria, i cili është përgjegjës për organizimin e provimeve shtetërore dhe publikimin e rezultateve për listën e profesioneve të rregulluara me këtë aplikon për të marrë licencën për një profesion të rregulluar;

Neni 3, nënparagrafi 1.7, riformulohet si vijon:

1.7. KSHPRR - Këshilli Shtetëror për Profesione të Rregulluara - organi vendimmarrës, i themeluar nga Ministria, i cili është përgjegjës për përcaktimin e standardeve për profesionet e rregulluara;

Neni 3, nënparagrafi 1.10, riformulohet si vijon:

1.10. Provimi shtetëror - vlerëson njohuritë dhe aftësitë e kandidatit për ushtrimin e profesionit të rregulluar sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3, nënparagrafi 1.11, riformulohet si vijon:

1.11. Kandidati - personi, i cili ka një dokument zyrtar të aftësimit apo kualifikimit dhe aplikon për të marrë licencën për një profesion të rregulluar;

Neni 3, nënparagrafi 1.15, riformulohet si vijon:

1.15. ENIC-NARIC Kosova - Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik ndihmon në promovimin e mobilitetit të studentëve, mësimdhënësve dhe hulumtuesve nëpërmjet ofrimit të këshillave dhe informatave të mirinformuara për njohjen akademike të diplomave dhe studimeve që janë fituar, në pajtim me standardet Evropiane;

4. Të ndryshme.

Mbledhja e ardhshme e Komisionit u caktua të mbahet të martën, më 2.2.2016, në orën 11:00, me ç'rast do të vazhdohet me shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për Profesionet e Rregulluara.

Mbledhja përfundoi në orën 13:50.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani